

S. Keshillit
13.01.2026

203
dt. 13.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 21/ prot.

Elbasan, më 12/1 .2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHID

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.115 dt.23.12.2025 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





05.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHDI
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë: 29.12.2025

Nr. 8572 prot

Nr. 115 dt. 23.12.2025

“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR E KULLOSOR PUBLIK”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Per pyjet”, VKM nr. 433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar”, VKM nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve”, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullor publik”, *Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me datë 23.12.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.*

VENDOSI :

1. Të miratojë me shkrim për dhënie në përdorim të sipërfaqes 2 ha nënëgastrën 98b në ekonominë pyjore Çermenikë për ushtrimin e veprimtarisë “Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektsh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe”.
2. Procedurat e mëtejshme ligjore do të ndiqen nga Sekretari i Përgjithshëm, Sektori Juridik, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bujqësisë dhe Turizmit të Bashkisë Librazhd, Drejtoria e Urbanistikës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU





REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI I BASHKISË
LIBRAZH D

P/VENDIM

Nr. _____, datë ____/____/2025

“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR E KULLOSOR PUBLIK”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Per pyjet”, VKM nr.433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-komunave/bashkive i ndryshuar”, VKM nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve”, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullor publik”, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë Librazhd të mbledhur sot më datë ____/____/2025 pasi dëgjoi relacionin e përfaqësuesve të bashkisë :

VENDOSI :

1. Të miratojë me shkrim për dhënie në përdorim të sipërfaqes 2 ha në ngastrën 98b në ekonominë pyjore Çermenikë për ushtrimin e veprimtarisë “Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe”.
2. Procedurat e mëtejshme ligjore do të ndiqen nga Sekretari i Përgjithshëm, Sektori Juridik, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bujqësisë dhe Turizmit të Bashkisë Librazhd, Drejtoria e Urbanistikës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

KONCEPTOI:

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bujqësisë dhe Turizmit
Përgjegjësi Menaxhimit
Aleksandër Brazhda

DREJTORI
Hysni Hoxha

KRYETARI I BASHKISË
Mariglen Disha

RELACION MBI PROJEKT-VENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR E KULLOSOR PUBLIK”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Per pyjet”, VKM nr.433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar”. VKM nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve”, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullor publik”.

Bashkia Librazhd kërkon që të jap në përdorim sipërfaqe prej 2 ha në ngastrën 98b të ekonomisë pyjore Çermenikë për ushtrimin e aktivitetit sipas VKM nr. 559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” shtojca 1 pika 9 “Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe”.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit (Sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave) ka kryer studimin e ngastrës dhe rezultoni që sipërfaqja që do të jepet në përdorim është me status përdorimi shkurre (shkozë) në të cilën ka në përbërje pjesë shkëmbore ku do të kryhet kryerja e këtij aktiviteti, pjesë këto në të cilën do të merren mostra për analizë të tyre. Sipërfaqja është përdorur tradicionalisht nga fisi Mjeshtri të cilët e kanë përdorur për kullotje të bagëtive si dhe nxjerrjes së thuprave, druve të zjarrit etj.

Kontrata që do të nënshkruhet ndërmjet palëve, subjekti apo personi juridik do të arkëtojë për llogari të bashkisë vlerën të përcaktuar sipas VKM nr. 559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” shtojca 1 pika 9 “Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe” sipas tarifave si më poshtë :

9. Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe			
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit	
		1-5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll trungishte	120 000	96 000
2	Pyll cungishte	96 000	78 000
3	Pyll shkurre	96 000	78 000
4	Kullota	96 000	78 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	76 800	62 000
6	Inproduktive	76 800	62 000

Theksojmë se veprimtaria e parashikuar në këto sipërfaqe do të jetë vetëm për matje gjeologjike, punime kërkimore dhe shpime testuese, pa përfshirë proces shfrytëzimi minerar.

Në rast se kërkimet do të arrijnë rezultat në këtë sipërfaqe të marrë në përdorim me kontratë qiraje atëherë për të ushtruar aktivitetin duhet që t'i nënshtrohet procedurave sipas VKM Nr. 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre” kreu III. “Dokumentacioni i nevojshëm ndryshimin e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre, për rastin e ndryshimit të kategorisë së përdorimit” në të cilën shpjegohet qartë mënyra për ushtrimin e veprimtarive në fondin pyjor/kullor publik.

Nisur nga arsyet e mësipërme ne propozojmë që të miratohet dhënia e dakortësisë për kryerjen e këtij operacion kërkim zbulimi në këtë sipërfaqe me qëllimin që do të ketë një ndikim pozitiv në të ardhmen për zhvillimin e kësaj veprimtarie në bashkinë Librazhd por dhe në gjenerimin e të ardhurave për komunitetin rrethues dhe buxhetin e bashkisë, rritjen e vlerave ekonomike në zone dhe krijimin e vendeve të reja pune. Aktiviteti ka impakt të ulët në mjedisin ku do të ushtrohet.

Për sa më sipër i kërkojmë Këshillit Bashkiak miratimin e ngastrës për fillimin e procedurave për dhënie në përdorim të fondit pyjor të Bashkisë Librazhd në mënyrë që Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit (Sektori i menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave) të vazhdojë procedurat e mëtejshme.

Bashkëngjitur këtij projekt vendimi po ju paraqesim:

- a. Fragment harte të objektit që kërkojmë të japim me qira.
- b. VKM nr. 559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”
- c. VKM Nr. 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”
- d. Anex Teknik - Pajisjet e Kërkim-Zbulimit që do të përdoren për marrjen e mostrave për studim.

Jemi në pritje të miratimit nga ana J'uj.

Përgjegjësi i Menaxhimit
Aleksandër Brazhda



DREJTORI
Hysni Hoxha



ANEX TEKNIK – Pajisjet e Kërkim–Zbulimit


Nr.	Pajisja	Përshkrimi	Përmasat Tipike	Pesha
1	Çekiç gjeologjik	Vegël bazë për mostra shkëmbi	28–32 cm × 14–16 cm	0.6–0.9 kg
2	Lupë gjeologjike	Analizë teksture	Ø 18–25 mm	-
3	Busull gjeologjike	Matje shtrirje/zhytje	8–10 × 6–7 × 3 cm	0.2–0.3 kg
4	GPS dore	Pozicionim terreni	10–14 × 5–7 × 3 cm	0.15–0.25 kg
5	Magnetometër	Matje anomalish magnetike	60–100 cm gjatësi	1–3 kg
6	Gravimetër	Matje densitetesh	20–35 × 20–25 × 20–30 cm	3–5 kg
7	GPR (Georadar)	Skanim i nëntokës	Antenë 40–80 × 20–40 cm	3–10 kg
8	Seismograf + gjeofonë	Matje sizmike	Njësia 25–35 cm; gjeofonët Ø 3–6 cm	5–12 kg
9	Sondë gjeologjike portative	Sondazhe diamant	1.2–1.8 m × 40–60 cm	80–250 kg
10	Tub karotazhi	Marrje karotash	Ø 35–76 mm; L 1.5–3.0 m	5–12 kg
11	Kuti karote	Ruajtje karotash	80–120 × 25–35 × 8–12 cm	2–4 kg
12	Mikroskop portativ	Analiza petrografike	15–25 × 10–15 × 20–25 cm	1–3 kg
13	XRF portativ	Analiza kimike	25–30 × 10–15 × 20–25 cm	1.3–1.8 kg
14	Total station	Matje gjeodezike	30–40 × 18–25 × 15–22 cm	4–7 kg
15	Dron topografik	Hartim fotogrametrik	Hapja 35–60 cm	0.9–1.6 kg
16	Radio komunikimi	Komunikim terreni	12–17 × 5–7 cm	0.2–0.3 kg
17	Pajisje sigurie	Helmetë, breza, litarë	Standard S/M/L	-

Vertetim

Une si fuqetor i fshatit Fdn - Vërr
Njësis Administrative oraj Haki Fuzegju
sipas kërkesës që më ka bërë
veiz Mjeshti për një zabel që ka
në lagjen e prapit nëna e vet
shygyrie Mjeshti mbasi vajtëm në vend
e verifikuam sipas hamllave të
dashkut që kanë qënë ndarë me
kanun të fshatit vendosëm dhe thirrëm
kufitarët që kufizohet me ta kryendz
~~ku~~ i palit prapit Luku i palit

Kufitar Nazim Met'hara
Ferd Leka
Fatmir Mjeshti
sipas kufitarve ku kufizohet

2-2025
Kryetari i fshatit
Fdn - vërr

Haki Fuzegju


VENDIM
Nr. 559, datë 29.7.2022

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE DHE TARIFAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM/PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KOMBËTAR, PËR VEPRIMTARI EKONOMIKE, SI DHE PËR PRODHIMET DRUSORE DHE JODRUSORE PYJORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të neneve 25, pika 4, dhe 27, pika 5, të ligjit nr. 57/2020, "Për pyjet", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve dhe tarifave për veprimtaritë që zhvillohen në Fondin PyJOR Kombëtar, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe shtojcave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, si më poshtë vijon:

a) Për dhënie në shfrytëzim/përdorim të Fondit PyJOR Kombëtar dhe për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në fondin pyJOR nga shfrytëzimi/përdorimi i tij.

b) Për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore dhe për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta pyjore dhe jopyjore;

2. Tarifat për dhënie në përdorim të Fondit PyJOR Kombëtar janë sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Tarifat dhe çmimet për shfrytëzimin e Fondit PyJOR Kombëtar janë sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Tarifat për sipërfaqet, që shfrytëzohen për heqjen nga Fondi PyJOR Kombëtar, përcaktohen duke marrë në konsideratë:

a) investimet e kryera për pyllëzimin (ripyllëzimin), si dhe ato gjatë periudhës së rritjes, në sipërfaqen që hiqet nga Fondi PyJOR Kombëtar;

b) shpenzimet e kryera për mbrojtjen e tokës, për shfrytëzim të qëndrueshëm dhe produktiv;

c) shpenzimet për ndërtimin e infrastrukturës përkatëse;

ç) vlerën e burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese (lënda drusore, flora spontane, fauna e egër, kullota etj.), si produkt i humbur;

d) investimet që do të kryhen për pyllëzimin (ripyllëzimin), për sipërfaqen që do të zëvendësojë sipërfaqen e hequr nga Fondi PyJOR Kombëtar.

5. Tarifat dhe çmimet për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore, për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta pyjore dhe jopyjore janë sipas shtojcës nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Për shitjen e lëndës drusore në këmbë, lëndë punimi dhe dru zjarri për njësi/m³ dhe materialit drusor të asortuar, që shitet në anë të rrugës, çmimi i shitjes përcaktohet, sipas çmimeve të tregut, por jo nën çmimin e kostos së prodhimit, e cila llogaritet sipas tarifave të kësaj shtojce.

6. Vendimi nr. 391, datë 21.6.2006, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1	Pyll trungishte	11 250 000	10 000 000
2	Pyll cungishte	8 500 000	8 000 000
3	Pyll shkurre	8 500 000	8 000 000
4	Kullota	8 500 000	8 000 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	6 500 000	5 500 000
6	Inproduktive	5 500 000	5 000 000

8. Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogeneratorë dhe fotovoltaike (stationet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj.).

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll trungishte	240 000	230 000	210 000
2	Pyll cungishte	192 000	184 000	176 000
3	Pyll shkurre	192 000	184 000	176 000
4	Kullota	192 000	184 000	176 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	156 000	150 000	143 000
6	Inproduktive	156 000	150 000	143 000

9. Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objekteve të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit	
		1-5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll trungishte	120 000	96 000
2	Pyll cungishte	96 000	78 000
3	Pyll shkurre	96 000	78 000
4	Kullota	96 000	78 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	76 800	62 000
6	Inproduktive	76 800	62 000

10. Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, naftë, gaz, tensioni elektrik etj.).

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/km/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll trungishte	240 000	220 000	175 000
2	Pyll cungishte	190 000	176 000	145 000
3	Pyll shkurre	190 000	176 000	145 000
4	Kullota	190 000	176 000	145 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	160 000	145 000	110 000
6	Inproduktive	150 000	145 000	110 000

11. Për ndërtim/përdorim rrugë për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës për sipërfaqen e marrë në përdorim lek/km/vit
1	Pyll trungishte	70 000
2	Pyll cungishte	50 000
3	Pyll shkurre	35 000
4	Kullota	35 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	30 000
6	Inproduktive	25 000

12. Vendosje kaminash për prodhim qymyr druri dhe esbikës së kovaçit, furrë gëlqereje, sheshe për depozitim të përkohshëm të materialeve të ndryshme (pika transiti) etj.

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit
1	Tokë me bimësi pyjore, djerrë	250 000
2	Inproduktive	100 000

13. Ndërtim linje të tensionit të lartë

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës km/vit
1	Pyll trungishte	60 000

	- në trungishte	ha	7.000.000
	- në cungishte	ha	4.000.000
	- në shkurre	ha	2.000.000
	- në pjesë të tjera të fondit pyjor	ha	1.500.000
7.	Zënie ose përdorim pa leje i fondit ose i pyjeve pa i dëmtuar ato:	ha	2.500.000
8.	Përvetësim dhe shitja pa leje:		
	- lëndë punimi	m ³	60.000
	- dru zjarri	mst	30.000
	- dru zjarri ngarkese kali	barrë	9.000
	- dru zjarri ngarkese gomari	barrë	6.000
	- dru zjarri ngarkese njeriu	barrë	3.500
	- hunj të ndryshëm deri në diametër 4 cm	copë	1.400
	- bandiera, bishta veglash, furde e furka, e të tjera si këto me diametër 4.1–12 cm	copë	4.000
9.	Prodhim, përvetësim dhe shitje pa leje		
a.	Fruta e fara:		
	- të njoma	kg	2.300
	- të thata	kg	4.500
b.	Rrëshirë pishe e katran	kg	1.200
c.	Fletë dafine:		
	- të njoma	kg	2.300
	- të thata	kg	4.500
d.	Bimë mjekësore e tanifere:		
	- të njoma	kg	5.400
	- të thata	kg	10.000
e.	Rrënjë e kucka shqope, mare, bushi e të tjera si këto	kg	10.000
f.	Thupra shelgu e lloje të tjera të kësaj natyre:		
	- të njoma	kg	1.100
	- të thata	kg	2.000
	- të zhveshura	kg	3.000
g.	Qymyr druri, eshk kovaçi, e të tjera të kësaj natyre	kg	30.000
h.	Fuçi, kade, govata druri, e të tjera të kësaj natyre, pavarësisht nga madhësia.	copë	15.000
i.	Kosha, shporta e të tjera të kësaj natyre prej thupra shelgu e lloje të tjera pyjore, pavarësisht nga madhësia	copë	10.000
10.	Ndërtim pa leje i furrave të gëlqeres, kamina për qymyr druri, eshkë kovaçi, katrani e të tjera të kësaj natyre, pavarësisht nga madhësia	copë	8.000
11.	Dëmtimi ose zhdukja e objekteve të mbarështimit, gjeodezike e topografike dhe të tjera të kësaj natyre, në fondin pyjor	copë	5.400
12.	Dëmtimi ose zhdukja e ndërtimeve apo strehimeve për shtimin e gjahut e të tjera si këto, kudo që ndodhen	copë	10.800
13.	Dëmtimi ose zhdukja e pikave dhe kullave të vrojtimit për ruajtjen e florës dhe faunës nga sëmundjet, insektet dhe zjarret	copë	8.000
14.	Dëmtimi i rrethimeve në fondin pyjor ose vende të tjera si këto	ml	5.400
15.	Kryerja e gjermimeve ose punimeve të tjera në fondin pyjor për nxjerrjen e gurëve, rrës, zhavorrit, dheu, humusit, plisave të barit e të tjera si këto	m ²	7.000
16.	Hapja e gropave pa leje dhe mosmbulimi i tyre	m ³	4.500
17.	Shkulja e cungjeve pa leje	copë	27.000
18.	Hapja pa leje në fondin pyjor e guroreve e karrierave	m ²	45.000
19.	Hapja e rrugëve, linjave telefonike, telegrafike, televizive, gazsjellëse, naftësjellës, kanaleve, linjave të tensionit të lartë, ujësjellësve e të tjera të kësaj natyre në fondin pyjor, pa miratimin përkatës	m ³	49.500
20.	Kullotja pa leje në fondin pyjor:		
	- për gjedhet	krerë	2.700
	- për të leshtat	krerë	1.350

16.	Herba të ndryshme	kV	200
17.	Fruta, fara dhe sytha	kV	500
18.	Lëvore	kV	350
19.	Kërpudha	kV	2 500
20.	Boçe të ndryshme	kV	500
21.	Degë të gjelbra, me dhe pa lule, për buqeta	kV	1000
B.	Nxjerrja ose grumbullim në sipërfaqen e fondit pyjor:		
a)	Gurë, rërë dhe zhavorr	m ³	35
b)	Dhe dhe humus	m ³	200
c)	Prodhim qymyr druri në sipërfaqen e fondit pyjor	kV	100

Sbënim. Tarifat e germës a, të pikës B të përdoren vetëm në rastin kur grumbullimi i materialeve të ndërtimit bëhet nga banorët e zonave rurale, për nevojat e tyre vetjake.

Në mbeturinat e pyllit do të futet vetëm ai material drusor (i kalbur, gjysmë i kalbur), i cili nuk plotëson parametrat për dru zjarri.

3/4. Tarifat e shitjes së pemëve të krishtlindjeve dhe të vitit të ri

Nr. ren.	Specifikimi	Njësia e matjes	Tarifa (lek)
1.	me lartësi deri në 1 m	copë	1 000
2.	me lartësi 1 deri 3 m	copë	2 000
3.	me lartësi 3 deri 5 m	copë	3 000
4.	me lartësi 5 deri 7 m	copë	5 000
5.	me lartësi mbi 7 m	copë	10 000

3/5. Tarifat e shitjes së fidanëve nga ripërtëritja natyrore, e shpatullave dhe e kalemave

Nr. ren.	Emërtimi	Njësia e matjes	Tarifa (lek)
1.	Fidanë, shpatulla dhe kalema:		
	- me moshë 1-vjeçare	copë	10
	- me moshë 2-vjeçare	copë	30
	- me moshë mbi 2-vjeçare	copë	50

VENDIM
Nr. 888, datë 27.12.2022

**PËR RASTET E DHËNIES NË PËRDORIM DHE PËR NDRYSHIMIN E
KATEGORISË SË PËRDORIMIT, PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONI
PËRKATËS PËR NDRYSHIMET E SIPËRFAQEVE DHE PAKËSIMIN NË VOLUM
NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR APO ZGJERIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i:

a) procedurave për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit të fondit pyjor kombëtar;

b) dokumentacionit përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve pyjore dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre.

2. Për qëllim të këtij vendimi, kanë kuptimin termat e mëposhtëm:

a) “Dhënie në përdorim”, procesi i kalimit të së drejtës së përdorimit të fondit pyjor te palët e treta, mbështetur në aktet ligjore në fuqi;

b) “Ndryshimi i kategorisë së përdorimit dhe/ose heqja nga fondi pyjor”, procesi i tjetërsimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore, pas miratimit nga organi përgjegjës për ushtrimin e veprimtarisë;

c) “Pakësimi në volum”, heqja e volumit drusor mbi atë sipërfaqe pyjore, ku do të ushtrohet veprimtaria e miratuar;

c) “Infrastrukturë pyjore” ka kuptimin, sipas përkufizimit të përcaktuar në ligjin nr. 57/2020, “Për pyjet”;

d) Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor ka kuptimin, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 57/2020, “Për pyjet”, dhe në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 171, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe Regjistrin e Fondit Kullosor, përcaktimin e strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”.

II. PROCEDURA PËR NDRYSHIMIN E SIPËRFAQEVE DHE PAKËSIMIN NË VOLUM NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR APO ZGJERIMIN E TYRE, PËR RASTIN E NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË PËRDORIMIT

1. Personi fizik ose juridik, që kërkon të kryejë procedurën për ndryshimin e kategorisë së përdorimit dhe pakësimin në volum të një sipërfaqeje nga fondi pyjor kombëtar, bën kërkesën nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*.

a) Kërkesa arkivohet elektronikisht në dosjen elektronike të krijuar si modul (*backend*) në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor;

b) Kërkesa bëhet sipas formularit të aplikimit, në ankesin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) Rolet e institucioneve të përcaktuara në këtë procedurë janë në aneksin nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës, shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e depozituar nga kërkuesi, si dhe

të nenit 5, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, subjekti kërkues kryen pagesën mbi vlerën e sipërfaqes pyjore të hequr apo të infrastrukturës pyjore të tjetërsuar:

- a) në llogarinë bankare të bashkisë kur sipërfaqja pyjore është pronë publike;
- b) në llogarinë bankare të pronarit privat, në rastin kur sipërfaqja pyjore është në pronësi private.

14. Procedura e ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore kryhet kur mbi këtë sipërfaqe miratohen veprimtari, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizikë apo nga organet e vetëqeverisjes vendore, të cilat tjetërsojnë kategorinë e përdorimit të sipërfaqes pyjore, për rastet e mëposhtme:

- a) Kthimin në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit apo të qendrave të banuara në zonat rurale;
- b) Ndërtimin e strukturave akomoduese në funksion të sipërmarrjes turistike dhe të veprimtarisë së agroturizmit;
- c) Ndërtimin e rrugëve automobilistike apo hekurudhore;
- ç) Shpimin dhe shfrytëzimin e puseve të naftës e të gazit;
- d) Veprimtarinë minerare e gjeologjike;
- dh) Aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit;
- e) Qëllime të strukturave ushtarake;
- ë) Qendra industriale dhe aktivitete me natyrë industriale dhe ose energjetike;
- f) Për qëllime të tjera publike, për rastet e përcaktuara në nenin 25, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”.

15. Përjashtohen nga kjo procedurë, projektet e ndërtimit të infrastrukturave lineare si rrugë, linja të transmetimit ajror, apo nëntokësore të energjisë elektrike, tubacionet apo kanalet e devijacionit, për HEC-e, panele diellore, impiante eolike, fotovoltaike, të naftës, të gazit, të telekomunikacionit, si dhe teleferikët, të cilat në përputhje me projektet e miratuara kërkojnë për çdo trase të pastruar nga vegjetacioni me gjerësi më të vogël se 10 m, për efekt kadastral, bëhet vetëm zvogëlim në volum, por jo në sipërfaqe, sipas legjislacionit në fuqi.

III. DOKUMENTACIONI I NËVOJSHËM NDRYSHIMIN E SIPËRFAQEVE DHE PAKËSIMIN NË VOLUM NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR APO ZGJERIMIN E TYRE, PËR RASTIN E NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË PËRDORIMIT

1. Dokumentacioni i përcaktuar më poshtë, në pikën 2, të këtij kreu, hartohet dhe përshtatet në funksion të portalit qeveritar *e-Albania* nga struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

2. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) Lejen e veprimtarisë të lëshuar nga institucioni qendror shtetëror, që mbulon veprimtarinë, sipas pikës 1, të kreut III, të këtij vendimi;
- b) Aktin e miratimit mjedisor, VNM/leje mjedisore;
- c) Planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartë topografike të digjitalizuar dhe të gjeoreferuar me shkallë 1:10000, në formatin “jpg” dhe në formatin “dwg” ose në formatin “*shapefile*”, ku të jenë evidentuar elementet kryesorë si kufijtë natyrorë, relievi, objektet eventuale, ngastrat pyjore që preken nga aktiviteti, së bashku me të dhënat kadastrale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të studimit apo projektit;
- ç) Raportin tekniko-ekonomik, të hartuar nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, për pyjet në administrim të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe pyjet private;
- d) Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të ndryshimit të kategorisë së përdorimit të fondit pyjor kombëtar nga ana e këshillit bashkiak, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore publike, si dhe për sipërfaqen pyjore në pronësi private, e cila do t’i nënshtrohet procedurave të ndryshimit të kategorisë së përdorimit (pakësim/shtesë), si dhe verifikimin e ligjshmërisë nga prefekti, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ANEKS 1

FORMULAR APLIKIMI

PËR NDRYSHIMIN E SIPËRFAQEVE DHE PAKËSIMIN NË VOLUM
NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR APO ZGJERIMIN E TYRE.

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: +3554 270622 E-mail: info@turizmi.gov.al Web: www.turizmi.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
<i>Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.</i>	

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

TË DHËNA TË DETYRUESHME

1. Emri i subjektit aplikues

2. NUIS (Numri identifikimit personal)

3. Adresa e subjektit

4. Personi që përfaqëson subjektin

5. Nr. Cel 6. E-mail:

7. Përmbledhje ekzekutive e subjektit aplikues (përshkrim i veprimtarisë që ushtron subjekti)

SEKSIONI B: INFORMACION MBI APLIKIMIN

- Kthimi në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit apo të qendrave të banuara në zonat rurale;
- Ndërtimin e strukturave akomoduese në funksion të sipërmarrjes turistike dhe të veprimtarisë së agroturizmit;
- Ndërtimin e rrugëve automobilistike apo hekurudhore;
- Shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit;
- Veprimtari minerare e gjeologjike;
- Aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit;
- Qëllime të strukturave ushtarake;
- Qendra industriale dhe aktivitete me natyrë industriale dhe ose energjitike;
- Për qëllime të tjera publike, për rastet e përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr. 57/2020.

Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar.

Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose email) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit.

Nënshkrimi i Aplikantit

Dita/Muaji/Viti

ANEKS 2

PËRDORUESIT, ROLET E PËRDORUESVE

Sipas workflow-t të përshkruar në kapitullit II të projekt VKM

Përdoruesit të cilët do të kenë akses në sistem do të jenë:

MTM (Drejtoria Përgjegjëse për Pyjet, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave), 61 bashkitë e Republikës, Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Rolet do të jenë:

Pritës – MTM - Drejtoria Përgjegjëse për Pyjet (Drejtori) - Sektori i Pyjeve (përgjegjësi i sektorit i cili ja kalon për shqyrtim) – Specialistit (shqyrton dhe verifikon rregullsinë e dokumentacionit të aplikimit dhe nëse e gjen të rregullt e dërgon tek mendimdhënësit më poshtë. Nëse jo e kthen për plotësim tek aplikuesi)

↓

Mendim Dhënës – 7 bashkia (kryetari) – strukturës përgjegjëse për pyjet (përgatit raportin tekniko-ekonomik dhe vendimin e këshillit bashkiak për dhënien e dakortësisë)

Pas përfundimit të të gjithë procedurës më sipër, dokumentacioni i mësipërm përcillet tek MTM

↓

Pritës ----- MTM - Drejtoria Përgjegjëse për Pyjet (Drejtori)- Sektori i Pyjeve (përgjegjësi i sektorit i cili ja kalon për shqyrtim) – Specialistit (dërgon për vlerësim raportin teknik tek AKP)

↓

Mendim Dhënës ---- AKP- struktura përgjegjëse për kadastrën (vlerësimin e saktësisë së raportit teknik)

↓

Pritës ----- MTM - Drejtoria Përgjegjëse për Pyjet (Drejtori)- Sektori i Pyjeve (përgjegjësi i sektorit i cili ja kalon për vijimin e procedurave) – Specialistit (përgatit aktin e miratimit)

↓

Drejtoria Përgjegjëse për Pyjet (Drejtori) ngarkon në sistem aktin e miratimit (urdhër ministri)